



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 62 , datë 30.04.2026

**“PËR KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VKB NR. 44 DATË 26.03.2026 “PËR
MIRATIMIN E SHKËMBIMIT TË PASURIVE NR. 4/1031, NR.4/168 ZK. 8564 DHE
NR.4/195, NR.4/1034 ZK 8564 MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SUBJEKTIT LARTI
SHPK”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, nenit 129 të Kodit të Procedurave Administrative si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të korrigjojë në VKB-në nr.44 datë 26.03.2026 “Për miratimin e shkëmbimit të pasurive nr. 4/1031, nr.4/168 zk. 8564 dhe nr.4/195, nr.4/1034 zk 8564 midis Bashkisë Korçë dhe subjektit Larti shpk” numrin e pasurisë nga 4/168 ZK 8564, Truall+Ndërtesë me sipërfaqe totale 232.5 m² truall nga të cilat 232.5 m² ndërtesë, në numrin e saktë 4/1035 ZK 8564, Truall+Ndërtesë me sipërfaqe totale 232.5 m² truall nga të cilat 232.5 m² ndërtesë në pronësi të Bashkisë Korçë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Bashkia Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 30-04-2026



KRYETAR

ANA VERUSHI